



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 06.03.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër te referencës: KJBNFV-0348, për zyrtaren e lartë Shukrije Morina, Zyrtare Kryesore e Financave dhe Thesarit në Ndërmarrjen Publike Komunale “Trafiku Urban” Prishtinë, për shkak nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin për ekzistimin e papajtueshmërisë respektivisht konfliktit të interesit.
- II. Është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik për shkak se janë bërë ndryshimet, konform nenit 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.
- III. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren e lartë Shukrije Morina, Zyrtare Kryesore e Financave dhe Thesarit në Ndërmarrjen Publike Komunale “Trafiku Urban” Prishtinë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: LPKI).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë): “ Shukrije Morina i ushtron dy pozita të zyrtarit të lartë që nga viti 2023, është e punësuar në trafikun urban si zyrtare e lartë, e njëjta është e angazhuar edhe ne një Bord të Drejtorëve që nga viti 2023 e cila realizon te ardhura edhe nga ky institucioni tjetër, ku në formularin e pasurisë nuk i ka te deklarume. E njëjta që nga vitit 2023 ka përfutuar 30,000.00 euro të ardhura. Andaj si institucion i kontrollit, deklarimit të pasurisë dhe kudër konfliktit te interesit shpresoj që do te reflektoni”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform mandatit dhe kompetencave ligjore që i ka sipas Ligjit Nr.08/-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar pretendimet për konflikt të interesit,

Në pajtim me nenin 22, paragrafin 3, dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia sipas procedurës përmes shkresës zyrtare (DPKI-206/25), e ka njoftuar zyrtaren e lartë Shukrije Morina, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Më qëllim të sqarimit të plotë të pretendimeve të ngritura nga raportuesi i rastit për zyrtaren e lartë Shukrije Morina, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtaren në fjalë, me ç' rast e njëjta është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit të ngritura për konflikt të interesit respektivisht papajtueshmëri në ushtrim të funksionit publik.

Në takim, palës i është sqaruar se në parim, me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, zyrtarit të lartë publik, në rastin konkret Zyrtarit Kryesor të Financave dhe Thesarit në NPL "Trafiku Urban", nuk i ndalohet që të ushtrojë njëkohësisht edhe funksionin e anëtarit të Bordit në NP "Termokos" sh.a., Prishtinë, por megjithatë dispozitat e Ligjit në fjalë kanë paraparë disa kufizime për situata të tilla, konkretisht dispozita e nenit 13, paragrafi 2 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Në këtë takim, zyrtarja e lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e saj lidhur me rastin në fjalë, të cilat më pas i ka përcjellë në Agjenci edhe në formë të shkruar. Në deklarimin e saj, ajo ka theksuar se: *"Në cilësinë e anëtares së Bordit të drejtorëve ne N.P. "Termokos" Sh.A., nuk jam në marrëdhënien pune dhe nuk përfitoj pagë, por vetëm kompensim për angazhim ne Bord. Ndërsa lidhur me OJQ e themeluar nga ajo dhe dy anëtarët tjerë në vitin 2015, ka sqaruar se e njëjta nuk është aktive që nga viti 2016 dhe nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet që nga ajo kohë. Megjithatë, me qëllim të respektimit të plotë të legjislacionit në fuqi dhe shmangies së çdo situatë që mund të interpretohet si konflikt i mundshëm i interesit, do të ndërmarr veprimet me të shpejta të nevojshme ligjore për shuarjen e saj apo ndryshimin e statusit tim në këtë organizatë"*.

I. Nga informatat që përmban raportimi për konflikt të interesit nga raportuesi i rastit, diskutimi nga takimi i mbajtur me zyrtaren e lartë Shukrije Morina, si dhe informacioni/ dokumentacioni në dispozicion (vendimin Nr. 685 të datës 13.03.2023 mbi emërimin anëtare e Bordit të drejtorëve ne NP "Termokos" Sh.A. Prishtinë), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin për ekzistimin e situatës së konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik, për zyrtaren e lartë Shukrije Morina.*

Mirëpo, nenin 13, paragrafi 2 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka përcaktuar: *"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të"*.

II. Gjithashtu zyrtares së lartë Shukrije Morina në takim i është bërë me dije se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtares së lartë publike, ajo nuk mund që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësuese e autorizuar në Organizatë Joqeveritare(OJQ), sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas sqarimit dhe diskutimit të fakteve, zyrtarja e lartë është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmangë papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është njoftuar nga Shukrije Morina se ka bërë ndryshimet e kërkuara në OJQ-në në fjalë, të cilat dëshmohet edhe përmes shkresës zyrtare “Lëtërkonfirmimi”, ku e njëjta nuk figuron më të jetë përfaqësuese e autorizuar në OJQ-në “Për ty Grua”.

Kësisoj, me veprimet e ndërmarra nga zyrtarja e lartë, janë krijuar rrethana të atilla me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë respektivisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Sa i përket pretendimit tjetër të raportuesit të rastit se ka realizuar të ardhura edhe nga një institucion tjetër pa i deklaruar ato në formularin e deklarimit të pasurisë, bazuar në informacionin e dhënë nga Departamenti për Deklarimin e Pasurisë rezulton se e njëjta në formularin për deklarimin e pasurisë së dorëzuar në vitin 2025 për vitin paraprak, ka deklaruar të hyrat nga Ndërmarrja Publike “Trafiku Urban” Prishtinë dhe nga Ndërmarrja Publike “Ngrohëtorja e Qytetit – Termokos” Prishtinë.”

III. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKIsë, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtares së lartë Shukrije Morina
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrtarit përgjegjës

